



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268142; 22268141

Nr. 1796 Prot.

Tiranë, më 08.11.2017

V E N D I M

Nr.226 , datë 08.11.2017

“Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 172, datë 19/07/2017, Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë administrimit të shërbimit civil nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit prej datës 20/05/2016 deri në momentin e verifikimit”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës.

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 172, datë 19.07.2017, të Komisionerit.

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 172, datë 19.07.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë administrimit të shërbimit civil nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit prej datës 20/05/2016 deri në momentin e verifikimit”.
2. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:

- | | |
|------------------------------|---|
| 1. Enkelejda Hebibasi | Drejtor i Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë |
| 2. Migena Haznedari | Specialiste, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë |
| 3. Joni Marko | Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë |

3. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt dhe grumbullimin e të dhënave që materializojnë zbatimin e vendimit, në datat **23 dhe 24 Nëntor 2017**.
4. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave. Relacioni duhet të përpilohet deri në datën **04.12.2017**. Më pas do t'i paraqitet për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohet vendimi për përmbylljen e procesit, brenda datës **11.12.2017**.
5. Vendimi përfundimtar i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e verifikimit do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
6. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
7. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që të sigurojë mbështetjen e grupit të verifikimit me logjistikë, për vijimin normal të procesit, në përputhje me programin e miratuar.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268142; 22268141

Nr. 1796/1 Prot.

Tiranë, 08.11.2017

M I R A T O H E T

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM VERIFIKIMI

"Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 172, datë 19/07/2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë administrimit të shërbimit civil nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, prej datës 20.05.2016 deri në momentin e verifikimit".

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** **Autoriteti Kombëtar i Ushqimit**
- 2. Objekti i verifikimit:** Zbatimi i Vendimit të Komisionerit Nr. 172, datë 19.07.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë administrimit të shërbimit civil nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit prej datës 20.05.2016 deri në momentin e verifikimit ", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 3. Baza ligjore:** Neni 14, i Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Rregullorja "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 4. Afati i verifikimit:** Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt dhe grumbullimin e të dhënave që materializojnë zbatimin e vendimit, në datat **23** dhe **24 Nëntor 2017**.
- 5. Procedura që do të ndiqet:** Për parregullsitë e konstatuara do të mbahen aktet e konstatimit, procesverbal administrativ, të cilët do të nënshkruhen nga grupi i verifikimit dhe

personat përgjegjës, si dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.

- 6. Grupi i punës:**
- | | |
|------------------------------|--|
| 1. Enkelejda Hebibasi | Drejtor i Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë |
| 2. Migena Haznedari | Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë |
| 3. Joni Marko | Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë |

7. Dokumentimi i rezultateve të verifikimit:

Në përfundim të procesit të verifikimit do të përgatitet relacioni përkatës nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, bazuar në aktet e konstatimit dhe procesverbali i mbajtur në subjektin e verifikuar si dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do të dërgohet institucionit (*nëse vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar*).

DREJTIMET E VERIFIKIMIT

- I.** Si janë zbatuar, detyrat e lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin Nr. 172, datë 19.07.2017, "*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë administrimit të shërbimit civil nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, prej datës 20.05.2016 deri në momentin e verifikimit*", nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit të mbikëqyrur. Në këtë rast, verifikimi do të realizohet duke pasur parasysh nivelin e zbatimit të urdhërimeve në vendimin paralajmërues, si më poshtë, duke administruar kopje të akteve që materializojnë zbatimin e vendimit:
- Të kërkoj nga Njësia përgjegjëse pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për plotësimin e procedurave të rekrutimit të 12 (dymbëdhjetë) emërimeve të reja të nxjerra me akt emërimi të përkohshëm nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së si më poshtë:*
 - Për punonjësin *****, me detyrë "Specialist", në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;*

- Për punonjësen *****, me detyrë “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
 - Për punonjësen *****, me detyrë “Inspektor”, në Sektorin e Koordinimit dhe Mbështetjes së Laboratorëve, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
 - Për punonjësin *****, me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Informimit të Shpejtë dhe Mbikëqyrjes së Tregut, në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
 - Për punonjësin *****, me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
 - Për punonjësin *****, me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
 - Për punonjësin *****, me detyrë “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë;
 - Për punonjësen *****, me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme”, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Elbasan;
 - Për punonjësen *****, me detyrë “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Vlorë;
 - Për punonjësin *****, me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Berat;
 - Për punonjësin *****, me detyrë “Drejtor i Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Vlorë”.
- ❖ Si dhe aktin e emërimit të nxjerrë nga Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, *****, me detyrë “Drejtor i Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë”.
2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë AKU-së të rregullojë përmbajtjen e akteve si dhe të nxjerrë akte të reja për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të transferimit (caktimit) të përkohshëm për punonjësit *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, si akte të nxjerra në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në nenin 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të

Ministrave, "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë".

3. Te kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë AKU-së, që në zbatim të nenit 113 të ligjit Nr.44/2015 të Kodit të Procedurave Administrative të Shqipërisë të rregullojë pasojat e paligjshmërisë në rastet e deklarimit të statusit të punësimit në kundërshtim me ligjin për shkak të mosrespektimit të afatit kohor të punësimit në pozicionin e shërbimit civil , në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil ,si më poshtë:

- Për punonjësin ***** të anulojë urdhrin e brendshëm nr. 1809, datë 11.05.2015, për transferimin e përkohshëm, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Elbasan dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin pozicionin "Inspektor", në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë
- Për punonjësen ***** të anulojë urdhrin e brendshëm nr. 6, datë 08.01.2016, për transferimin e përkohshëm, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Elbasan dhe të vendosë kthimin e saj në pozicionin "Inspektor", në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Korçë;
- Për punonjësin ***** të anulojë urdhrin nr. 1920 prot., datë 20.05.2016, për transferimin e përkohshëm , pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Elbasan dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin "Inspektor", në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Vlorë
- Për punonjësin ***** të anulojë urdhrin nr. 2457 prot., datë 22.08.2016, për transferimin e përkohshëm , pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Durrës dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin "Inspektor", në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Fier;
- Për punonjësin ***** të anulojë urdhrin nr. 3438 prot., datë 18.08.2016, për transferimin e tij, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Tiranë dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin "Inspektor", në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Vlorë;
- Për punonjësin ***** të anulojë urdhrin e brendshëm nr. 1600 prot., datë 28.04.2016, për transferimin e tij, pranë Drejtorisë së Përgjithshme AKU dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin "Inspektor", në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Berat;

- *Për punonjës të anuluar urdhrin e brendshëm nr. 5 prot., datë 08.01.2016, për transferimin e tij, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Korçë dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Gjirokastrë;*
- *Për punonjës të anuluar urdhrin nr. 1680 prot., datë 06.05.2016, për transferimin e tij pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Tiranë dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inpoteve Bujqësore pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU.*

Për të rregulluar situatën e paligjshme për punonjësit e mësipërm Autoriteti Kombëtar i Ushqimit si njësi qendrore duhet të ketë parasysh:

- Përcaktimin në akt të afatit (kohëzgjatjes) së transferimit të përkohshëm, i cili nuk duhet të jetë më shumë se 6 muaj, në 2 vjet.*
 - Marrjen e miratimit nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike.*
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit duhet të tregojë kujdes që në të ardhmen të marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e rregullave ligjore për të garantuar një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, duke garantuar të drejtat e nëpunësve civilë të cilët ushtrojnë detyrën në këtë institucion, nëpërmjet administrimit të shërbimit civil, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij*
 - Njësia përgjegjëse e AKU-së, të fillojë zbatimin e vendimit brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative, që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen, për zbatimin e këtij vendimi sipas fazave që do të realizohet.*
 - Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmëruar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të nenit 15, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.*

Në rast të konstatimit të moszbatimit të pjesshëm apo të plotë të vendimit të Komisionerit, do të mbahet procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

- II.** Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.

1. Provat shkresore të cilat vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin paralajmërues.
2. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të verifikimit.

**DREJTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE
DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Enkelejda HEBIBASI